



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

RAPORT VJETOR

**PËR VEPRIMTARINË E KËSHILLIT TË EMËRIMEVE NË DREJTËSI (I PËRKOHSHËM) I ZGJEDHUR ME SHORT NGA KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËR VITIN 2019**

**1. Hyrje mbi legjislacionin ku mbështetet veprimtaria e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, si edhe përgatitja e publikimi i Raportit Vjetor të veprimtarisë së Këshillit gjatë vitit 2019**

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (I përkohshëm) i zgjedhur me short nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ka ushtruar dhe përmbushur kompetencat dhe përgjegjësitë e ngarkuara nga Kushtetuta dhe ligjet për vitin kalendarik 2019.

Në shkronjën “ç” të pikës 1 të nenit 226 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, ndërmjet të tjerave, parashikohet se Kryetari i Këshillit :

“ç) harton dhe bën publik në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë raportin vjetor mbi veprimtarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi;”

Në zbatim të kësaj dispozite përpilohet dhe bëhet publik ky Raport Vjetor i cili përmban në mënyrë të përmbledhur veprimtarinë që ka zhvilluar Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (I përkohshëm) gjatë vitit 2019.

Në nenin 149/d të Kushtetutës parashikohet se:

*“1. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi kryen verifikimin e kushteve ligjore dhe vlerësimin e kritereve profesionale e morale të kandidatëve për Inspektor të Lartë të Drejtësisë, si dhe të kandidatëve për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi shqyrton dhe rendit kandidatët sipas meritës profesionale. Renditja e kandidatëve nuk është e detyrueshme, me përjashtim të rastit kur nuk arrihet të emërohet kandidati.*

*2. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi mblidhet sa herë është e nevojshme.*

***Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (I Përkohshëm) 2019***

Adresa Postare : **GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.**

Adresa Elektronike : **info@ked.gov.al** Numra telefonikë : **+355 4 2257302**

3. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi përbëhet nga 9 anëtarë të përzgjedhur me short, nga radhët e gjyqtarëve dhe prokurorëve, ndaj të cilëve nuk është dhënë masë disiplinore. Ata ushtrojnë detyrën me mandat njëvjeçar, që fillon në datën një janar të çdo viti kalendarik. Presidenti i Republikës përzgjedh me short, midis datave 1 dhe 5 dhjetor të çdo viti kalendarik, dy gjyqtarë nga Gjykata Kushtetuese, një gjyqtar nga Gjykata e Lartë, një prokuror nga Prokuroria e Përgjithshme, dy gjyqtarë dhe dy prokurorë nga gjykatat e apelit, si dhe një gjyqtar nga gjykatat administrative. Nëse Presidenti i Republikës nuk arrin të zgjedhë anëtarët deri në datën 5 dhjetor, Kryetari i Kuvendit i zgjedh ata me short brenda datës 10 dhjetor të atij viti kalendarik. Avokati i Popullit merr pjesë si vëzhgues në procedurën e hedhjes së shortit si dhe në mbledhjet dhe veprimtarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

4. Kryetar i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi është anëtari i Gjykatës së Lartë. Gjykata e Lartë krijon kushtet e punës për ushtrimin e veprimtarisë së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

5. Krite të tjera për shkallën e kualifikimit të kandidatëve që marrin pjesë në short parashikohen me ligj. Organizimi dhe funksionimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi rregullohet me ligj.”.

Në zbatim të nenit 149/d të sipërcituar të Kushtetutës, si edhe, mes të tjerave, të neneve 125 dhe 147/d të Kushtetutës, lidhur me organizimin, funksionimin, veprimtarinë, kompetencat dhe procedurat që ndjek e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, Kuvendi ka përcaktuar rregulla më të hollësishme në ligjin nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në Pjesën IV Kreu 2 nenet 199 dhe 201, në Pjesën V nenet 217 deri 242 dhe në Pjesën VII nenet 282 dhe 284. Po kështu, rregulla më të hollësishme për kompetencat dhe procedurat që ndjek Këshilli në verifikimin e kandidatëve, si edhe për vlerësimin, pikëzimin dhe renditjen e kandidatëve të lejuar parashikohen edhe në ligjin nr.8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, veçanërisht në nenet 7, 7/a, 7/b, 7/c, 7/ç, dhe 9 të këtij ligji.

Gjithashtu, ligjvënësi, në pikën 1 të nenit 229 të ligjit nr.115/2016 ka përcaktuar se “Këshilli e ushtron veprimtarinë e tij në mënyrë kolegjiale, sipas rregullave dhe procedurave të parashikuara në këtë kre, të cilat, plotësohen, për aq sa është e mundur dhe me ndryshimet e nevojshme, nga rregullat e parashikuara në legjislacionin për organizimin dhe funksionimin e organeve kolegjiale. Pjesëmarrja në mbledhjet e Këshillit është e detyrueshme. Anëtarët që mungojnë zëvendësohen nga anëtarët zëvendësues.”.

Njëkohësisht, Kuvendi, nëpërmjet pikës 2 të nenit 229 të ligjit nr.115/2016, i ka deleguar Këshillit të Emërimeve në Drejtësi detyrën që të nxjerrë edhe aktet e nevojshme nënligjore normative “për të siguruar zhvillimin e një procedure transparente, publike dhe bazuar në merita, me vendim, miraton rregulla më të detajuara për përzgjedhjen dhe pikëzimin e kandidatëve, duke përfshirë edhe rregullat për procedurën e verifikimit të pasurisë, integritetit dhe të së shkuarës profesionale dhe personale të tyre.”.

**2. Përbërja e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (I Përkohshëm) i zgjedhur për ushtrimin e përgjegjësi dhe kompetencave kushtetuese e ligjor për vitin kalendarik 2019.**

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, me përbërjet përkatëse të zgjedhura me short për vitet e mëparshme kalendarike, nuk është mbledhur dhe nuk i ka ushtruar funksionet dhe përgjegjësitë përkatëse kushtetuese dhe ligjore, me përjashtim të Këshillit të caktuar për vitin 2018, i cili, me përbërjen e tij të zgjedhur me short ka zhvilluar vetëm një mbledhje në datën 19.03.2018, si edhe disa veprimtari të kufizuara përgatitore për aktet nënligjore nëpërmjet tre anëtarëve të mbetur në përbërjen e tij pas konfirmimit në detyrë nga organet e rivlerësimit kalimtar dhe shkarkimit nga detyra, përgjatë këtij viti kalendarik, të anëtarëve të tjerë të tij.

Në zbatim të nenit 149/d të Kushtetutës dhe nenit 284 të ligjit nr.115/2016, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, në datën 07.12.2018, realizoi procesin e shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (I Përkohshëm) për të ushtruar veprimtarinë dhe kompetencat përkatëse për vitin 2019.

Procesverbali dhe rezultati i shortit të shpallur nga Kuvendi, për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (I Përkohshëm) për vitin kalendarik 2019, janë të administruara pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, por njëkohësisht gjenden të publikuara, si në faqen elektronike të Kuvendit, ashtu edhe në faqen elektronike të Gjykatës së Lartë, pjesa e caktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

Sipas shortit të organizuar nga Kuvendi, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (I Përkohshëm) i zgjedhur për vitin 2019, rezultoi me këtë përbërje:

Anëtarë të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi:

- |    |                  |   |
|----|------------------|---|
| 1. | Vitore Tusha     | Gjyqtare e Gjykatës Kushtetuese         |
| 2. | Bashkim Dedja    | Gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese          |
| 3. | Ardian Dvorani   | Gjyqtar i Gjykatës së Lartë             |
| 4. | Arta Marku       | Prokurore nga Prokuroria e Përgjithshme |
| 5. | Fatri Islamaj    | Gjyqtar nga gjykatat e apelit           |
| 6. | Margarita Buhali | Gjyqtare nga gjykatat e apelit          |
| 7. | Fatjona Memçaj   | Prokurore pranë gjykatave të apelit     |
| 8. | Eriol Roshi      | Gjyqtar nga gjykatat administrative     |

Anëtarë zëvendësues të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi:

- |    |                       |                                      |
|----|-----------------------|--------------------------------------|
| 1. | Medi Bici             | Gjyqtar i Gjykatës së Lartë          |
| 2. | Gurali Brahimllari    | Gjyqtar nga gjykatat e apelit        |
| 3. | Klodiana Veizi (Mema) | Gjyqtare nga gjykatat administrative |

Nga ky proces zgjedhje rezultoi se Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (I Përkohshëm), i zgjedhur për vitin 2019, përbëhej nga 8 anëtarë, pra me një anëtar më pak, për shkak të mungesës së kandidatëve që plotësonin kushtet e zgjedhshmërisë nga prokurorët e Prokurorive pranë gjykatave të apelit.

***Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (I Përkohshëm) 2019***

Adresa Postare : **GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri**

Adresa Elektronike : **info@ked.gov.al** Numra telefonikë : **+355 4 2257302**

Gjithashtu, për shkak të mungesës së kandidatëve që plotësonin kushtet e zgjedhshmërisë, ky Këshill nuk ishte i plotësuar edhe me një anëtar zëvendësues nga gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, një prokuror nga Prokuroria e Përgjithshme dhe një prokuror nga Prokuroritë pranë gjykatave të apelit.

Në datën 17.12.2018, me vendimin nr. 12/2018, Kolegji i Posaçëm i Apelit vendosi shkarkimin nga detyra të Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, zotit Bashkim Dedja, njëkohësisht anëtar i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (I Përkohshëm), të zgjedhur për vitin 2019. Për rrjedhojë, ende pa filluar viti kalendarik i veprimtarisë së këtij Këshilli, numri i anëtarëve në përbërje të tij u zvogëlua në 7 anëtarë.

Në datën 21.06.2019, me vendimin nr.166, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka vendosur shkarkimin nga detyra të zotit Gurali Brahimllari, gjyqtar i Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, njëkohësisht anëtar zëvendësues i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (I Përkohshëm) të zgjedhur për vitin 2019.

Ndërsa në datën 10.12.2019, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka vendosur shkarkimin nga detyra të zotit Fatri Islamaj, gjyqtar i Gjykatës së Apelit Tiranë, njëkohësisht anëtar i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (I përkohshëm) të zgjedhur për vitin 2019 .

Për rrjedhojë, për pjesën e mbetur të muajit Dhjetor e deri në fund të vitit 2019, numri i anëtarëve në përbërje të Këshilli të Emërimeve në Drejtësi (I përkohshëm) i zgjedhur për vitin 2019, u zvogëlua në 6 anëtarë.

### **3. Problematikat e gjetura nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (I Përkohshëm), i zgjedhur për vitin kalendarik 2019 për ushtrimin e përgjegjësisë dhe kompetencave kushtetuese**

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (I Përkohshëm), i zgjedhur për vitin 2019, menjëherë me fillimin e veprimtarisë së tij, është gjendur përballë një numri të konsiderueshëm dhe pazakontë sfidash dhe problematikash të cilat duhet të gjenin zgjidhje, madje në kohë të shpejtë e të arsyeshme, sepse ato e pamundësonin fillimin dhe ushtrimin e kompetencave dhe të përgjegjësisë që i ngarkon Kushtetuta dhe ligjet këtij Këshilli.

Kjo gjendje, e krijuar për shkak të mosfunksionimit, për arsye të ndryshme, të Këshillave të zgjedhur për të ushtruar detyrën kushtetuese në vitet e mëparshme kalendarike, ishte rrjedhojë e :

- a) mospërgatitjes dhe mosmiratimit të akteve nënligjore të brendshme dhe atyre me natyrë normative që ligji ia delegonte Këshillit,
- b) administrimit të dokumentacionit, por pa kryer asnjë veprim verifikues, njëkohësisht për të nëntë vendet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, për të cilat kishin shprehur interesin për kandidim një numër i konsiderueshëm kandidatësh,
- c) mungesës së personelit mbështetës administrativ të nevojshëm për Këshillin nga ana e Gjykatës së Lartë, si edhe të ambienteve dhe pajisjeve të pamjaftueshme apo të papërshtatshme në dispozicion të veprimtarisë së Këshillit.

#### ***Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (I Përkohshëm) 2019***

Adresa Postare : **GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodë Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.**

Adresa Elektronike : **info@ked.gov.al** Numra telefonikë : **+355 4 2257302**

Në këto rrethana, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (I Përkohshëm) i zgjedhur për vitin 2019, ishte i detyruar të fillonte veprimtarinë e tij me përgatitjen e projektakteve nënligjore me natyrë të brendshme dhe atyre normative, si edhe me vlerësimin e situatës dhe parashikimin e ngarkesës së punës e të nevojave buxhetore, për burime njerëzore, ambiente dhe pajisje teknike etj., të domosdoshme për të përballuar proceset e verifikimit, vlerësimit dhe renditjes, njëkohësisht, për të gjitha vendet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe për Inspektorin të Lartë të Drejtësisë.

#### **4. Veprimtaria përgatitore, diskutimi dhe miratimi i akteve nënligjore rregullatore dhe normative të deleguara nga ligji**

Për realizimin e veprimtarive të përgatitjes, diskutimit dhe miratimit në mbledhjet e Këshillit të akteve nënligjore të domosdoshme për të mundësuar ushtrimin e kompetencave dhe përgjegjësi kushtetuese të lidhura me verifikimin, vlerësimin, pikëzimin dhe renditjen e kandidatëve për të gjitha vendet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (I Përkohshëm) i zgjedhur për vitin 2019, krahas angazhimit dhe punës së kryer nga anëtarët e tij, bashkëpunoi intensivisht dhe u mbështet në asistencën dhe ekspertizën ndërkombëtare, kryesisht të EURALIUS, misioni i Komisionit Evropian me detyra për të asistuar dhe mbështetur institucionet shqiptare në përgatitjen dhe miratimin e nismave të lidhura me reformën në sistemin e drejtësisë, të cilët, me ekspertët, mendimet dhe materialet e përgatitura, dhanë një kontribut të paçmueshëm në realizimin me sukses dhe në kohën më të shpejtë të arsyeshme e të mundshme të këtyre proceseve legjislativë.

Prandaj, përveç masave të tjera të shumta organizative dhe administrative për përgatitjen e domosdoshme në funksion të mbështetjes së Këshillit për zbatimin e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidaturave, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (I Përkohshëm) i zgjedhur për vitin 2019 përgatiti, diskutoi dhe miratoi në 15 mbledhje të tij, të periudhës 15 Janar deri në 2 Prill 2019, aktet nënligjore që përmbajnë një numër të konsiderueshëm rregullash të hollësishme, si më poshtë:

- *Rregullore e Brendshme për Funkcionimin e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi*, miratuar me Vendimin nr.1, datë 08.02.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.
- Vendimi nr.2, datë 15.02.2019, akt nënligjor normativ, *“Për procedurën e shortit të caktimit të relatorëve për pozicionet vakante në çdo institucion”*.
- Vendimi nr.4, datë 11.03.2019, akt nënligjor normativ, *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*.
- Vendimi nr.5, datë 02.04.2019, akt nënligjor normativ, *“Për kriteret dhe procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*.

#### ***Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (I Përkohshëm) 2019***

Adresa Postare : **GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.**

Adresa Elektronike : **info@ked.gov.al** Numra telefonikë : **+355 4 2257302**

Gjithashtu, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (I Përkohshëm) i zgjedhur për vitin 2019, përgatiti, diskutoi dhe miratoi në 4 mbledhje të tij, të periudhës 10 Maj deri në 21 Qershor 2019, dy dokumente orientuese që mbahen parasysh Këshilli në vlerësimin dhe caktimin e pikëve të kandidatëve të lejuar, si më poshtë:

- *Metodologjia për Vlerësimin dhe Caktimin e Pikëve për Renditjen e Kandidatëve për Gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese*, e miratuar nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi me vendimin nr.51 datë 21.06.2019.
- *Metodologjia për Vlerësimin dhe Caktimin e Pikëve për Renditjen e Kandidatëve për Inspektor i Lartë i Drejtësisë*, e miratuar nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi me vendimin nr.52 datë 21.06.2019.

##### **5. Masa organizative dhe administrative të marra nga Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (I Përkohshëm) i zgjedhur për vitin kalendarik 2019.**

Për sa i përket masave organizative dhe administrative të domosdoshme për fillimin dhe përmbushjen, në kushte sa më normale të mundshme, të veprimtarisë së tij tërësisht të paparashikuar më parë dhe të jashtëzakonshme, jo vetëm për procesin legjislativ të përgatitjes dhe miratimit të akteve nënligjore, por mbi të gjitha për realizimin me cilësi, thellësi dhe me shpejtësinë që e parashikon Kushtetuta dhe ligjet, aq më tepër në rrethanat e diktuar të administrimit të dokumentacionit dhe të zhvillimit të njëkohshëm të procedurave të verifikimit, vlerësimit dhe renditjes për të gjitha vendet vakante në Gjykatën Kushtetuese edhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, institucione të cilat nuk ishin funksionale, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (I Përkohshëm) i zgjedhur për vitin 2019 u angazhua për të vlerësuar nevojat dhe kërkesat për mbështetje të mëtejshme nga Gjykata e Lartë, sikurse e përcakton ligji, me burime njerëzore e buxhetore, ambiente pune dhe pajisje e teknologji të domosdoshme.

Në fillim të veprimtarisë së tij, sipas atyre pak masave që ishin marrë gjatë vitit 2018, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (I Përkohshëm) i zgjedhur për vitin 2019 ka pasur në dispozicion vetëm një ambient pune të destinuar për Këshillin dhe dokumentacionin që shqyrton dhe administron, një punonjëse për të ushtruar detyrat e sekretarisë-protokollit-arshivës, një këshilltar ligjor dhe një specialiste për median.

Nisur nga përgjegjësitë dhe kompetencat që i ngarkon Kushtetuta dhe ligjet, këto masa ishin tërësisht të pamjaftueshme për realizimin e veprimtarisë së pritshme jo të zakonshme të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (I Përkohshëm) të zgjedhur për vitin 2019, madje as edhe në kushtet e një ngarkese normale pune. Ndërkohë që për vitin 2019 ky Këshill duhet të përballonte dhe realizonte rekuperimin e të gjitha problematikave të shkaktuara në organizim, funksionim, përgatitjen e akteve nënligjore dhe zhvillimin e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për të gjitha vakancat, të shkaktuara nga mosfunksionimi i Këshillave të mëparshëm. Gjithashtu, ky Këshill duhet të përballonte edhe veprimtaritë e tjera të mundshme shtesë në lidhje me zbatimin e procedurave për vendet vakante që krijoheshin gjatë vitit kalendarik 2019.

##### ***Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (I Përkohshëm) 2019***

Adresa Postare : **GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodë Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.**

Adresa Elektronike : **info@ked.gov.al** Numra telefonikë : **+355 4 2257302**

Për këtë qëllim, në mbledhjet e tij të para, menjëherë Këshilli analizoi dhe vlerësoi situatën duke ardhur në përfundimin se duhet të rritej ndjeshëm mbështetja me personel administrativ, ambiente pune, pajisje e teknologji të domosdoshme dhe me burime njerëzore e buxhetore të Gjykatës së Lartë, sikurse e përcakton ligji. Nga ana tjetër, plotësimi i këtyre kushteve të domosdoshme të punës për Këshillin dhe në masën që mund e duhej të kërkohej nga ana e Gjykatës së Lartë, rezultoi mjaft problematike për tu realizuar sepse, për shkaqe të njohura tashmë, përgjatë gjithë vitit 2019, vetë Gjykata e Lartë gjendej dhe vijon të jetë në një gjendje të jashtëzakonshme.

Në këtë Gjykatë nuk mungojnë gjyqtarët, por edhe numri i këshilltarëve ligjore ishte dhe mbetet i zvogëluar ndjeshëm, sikurse ka pasur dhe vijon të ketë mungesa organike edhe në përbërjen e sekretarisë gjyqësore. Ndërkohë që, nga ana tjetër, për shkaqe të tjera objektive, me gjithë masat e marra nga Gjykata e Lartë, numri i dosjeve gjyqësore në pritje për shqyrtim ishte jashtëzakonisht i lartë dhe gjendja vijoj të përkeqësohet gjatë gjithë vitit 2019. Në të tilla rrethana, në kushtet kur me të njëjtat burime duhet të realizohet njëkohësisht edhe mbështetja e veprimtarisë së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, mundësitë e Gjykatës së Lartë për të vënë në dispozicion të Këshillit burime buxhetore, njerëzore, pajisje etj. ishin dhe mbeten tejet të kufizuara, për të mos e cenuar edhe realizimin, aq sa ishte dhe është e mundur, të veprimtarisë së vetë kësaj Gjykate.

Në përgjigje të kërkesave të Këshillit, në 6 mujin e parë, Gjykata e Lartë ka rritur numrin e personelit mbështetës për veprimtarinë dhe mbledhjet e Këshillit, duke shtuar kohë pas kohe edhe gjashtë specialistë të tjerë: tre këshilltarë ligjorë, dy sekretare dhe një specialist të teknologjisë së informacionit. Njëkohësisht, në dispozicion të veprimtarisë dhe mbledhjeve të Këshillit, krahas sallës së mbledhjeve tashmë janë në dispozicion edhe dy ambiente të tjera pune, si edhe janë shtuar disa pajisje teknologjike pune për komunikimin, përgatitjen, përpunimin dhe administrimin e informacionit.

Gjithashtu, për përballimin e situatës së pazakontë dhe të paparashikuar, me nismën e Këshillit dhe mbështetjen e plotë të Ministrisë së Drejtësisë, Këshilli i Ministrave, me vendimin nr. 298 datë 10.05.2019 “*Për një shtesë fondi, nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit për sistemin e drejtësisë, miratuar për vitin 2019*” miratoi një fond shtesë prej 13.229.904 Lekë në buxhetin e Gjykatës së Lartë, me destinacion shpërblimin e anëtarëve të Këshillit, shpenzimet shtesë për personelin dhe ekspertët, si edhe për shpenzimet e tjera operative të lidhura me veprimtarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (I Përkohshëm) i zgjedhur për vitin 2019, nisur nga detyrimet që burojnë nga ligji dhe për të lehtësuar e siguruar komunikimin mes anëtarëve, me institucionet dhe me publikun, përfshirë edhe synimin për të garantuar transparencë, me gjithë vështirësitë objektive dhe kufizimet aktuale teknologjike që ofrojnë shërbimet në dispozicion të Gjykatës së Lartë, organizoi punët, përgatiti dhe vendosi në funksionim në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, një seksion të posaçëm me informacione të detajuara për veprimtaritë dhe mbledhjet e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, legjislationin ku mbështetet, natyrën e veprimtarisë së Këshillit, përbërjen e tij, vendet vakante që shqyrtohen, kandidatët e kandiduar në këto vende vakante, vendimet e arsyetuara të Këshillit të çdo lloji, komunikimin me median dhe me publikun, pranimin e informacioneve që mund të vijnë nga publiku etj.

#### ***Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (I Përkohshëm) 2019***

Adresa Postare : **GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.**

Adresa Elektronike : **info@ked.gov.al** Numra telefonikë : **+355 4 2257302**

Njëkohësisht, për realizimin e komunikimit zyrtar elektronik të anëtarëve të Këshillit dhe personelit mbështetës, si edhe me kandidatët, organe të emërtesës, institucione publike dhe subjekte të tjera për efekt të këmbimit dhe dërgimit të sigurtë të informacioneve, përfshirë edhe lehtësimin e komunikimit me publikun, me mbështetjen e AKSHI-it, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (I Përkohshëm) i zgjedhur për vitin 2019 ka vendosur një sistem të adresave zyrtare elektronike të dedikuar për veprimtarinë e Këshillit.

**6. Fillimi i veprimtarisë së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi për verifikimin, vlerësimin, pikëzimin dhe renditjen e kandidatëve. Realizimi i shortit për caktimin e anëtarëve të Këshillit relatorë për secilin vend vakant**

Kushtetutbërësi ka parashikuar që Këshilli i Emërimeve në Drejtësi do të investohet për të ushtruar kompetencat e tij, kohë pas kohe, atëherë kur të lindte nevoja për këtë qëllim, pra kur do të krijohet ndonjë vend vakant, i parashikuar rregullisht apo i parakohshëm në Gjykatën Kushtetuese dhe për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë. Prandaj, nuk ka vlerësuar të nevojshëm që ky organ kushtetues kolegjal të ushtronte veprimtarinë e tij me kohë të plotë dhe i pajisur me buxhetin, burimet njerëzore, pajisjet dhe infrastrukturën përkatëse, duke gjetur si zgjidhje plotësimin e këtyre nevojave nëpërmjet mbështetjes administrative nga Gjykatës së Lartë.

Por, për shkak të krijimit të njëpasnjëshëm dhe të shpejtë të vendeve vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe shpalljes së tyre sipas ligjit nga organet e emërtesës, krahas atij të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, si edhe për shkak të mosfunksionimit të Këshillave të mëparshëm, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (I Përkohshëm) i zgjedhur për vitin 2019 është gjendur përballë një situatë që shkon përtej parashikimeve kushtetuese e ligjore të mënyrës së organizimit dhe funksionimit të këtij organi kushtetues, si organ kolegjal *ad hoc*, me kohë të pjesshme, pra ku anëtarët e tij kryejnë njëkohësisht edhe funksionet e tjera kushtetuese gjyqësore, pa buxhet, infrastrukturë dhe personel të vetë Këshillit, sikurse janë institucionet e tjera kushtetuese dhe të administratës publike.

Në këto rrethana, pra të administrimit dhe të detyrimit kushtetues e ligjor për të proceduar njëkohësisht me të gjitha vendet vakante, pasi përgatiti dhe miratoi aktet nënligjore të brendshme dhe normative të domosdoshme pa të cilat nuk mund të procedonte më tej me shqyrtimin e vendeve vakante dhe të kandidaturave përkatëse, si edhe pasi realizoi një numër të madh masash legjislativë dhe të tjera përgatitore, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (I Përkohshëm) i zgjedhur për vitin 2019, në datën 5 Prill 2019 filloi zyrtarisht procedurat e verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe të renditjes së kandidatëve për të gjitha këto vende vakante.

Në zbatim të nenit 228 të Ligjit nr. 115/2016 dhe të pikave 5, 27 deri 37 dhe 41 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 2 datë 15.02.2019 “Për procedurën e shortit të caktimit të relatorëve për pozicionet vakante në çdo institucion”, si edhe të pikës 4 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, në të njëjtën ditë të mbledhjes së zhvilluar në datën 05.04.2019, është realizuar edhe procedura për caktimin me short të relatorëve për secilin vend vakant.



Sipas pikave 2 dhe 3 të nenit 228 të ligjit nr.115/2016, shorti për caktimin e relatorit organizohet përmes sistemit të administrimit të çështjeve të Gjykatës së Lartë. Përfundimisht, në qoftë se sistemi elektronik nuk funksionon, shorti mund të kryhet manualisht.

Në zbatim të ligjit, Këshilli ka njoftuar Gjykatën e Lartë për kohën e realizimit të shortit dhe mundësinë e organizimit të tij përmes sistemit elektronik të administrimit të çështjeve të Gjykatës së Lartë.

Gjykata e Lartë ka njoftuar Këshillin, duke paraqitur edhe një raport teknik me shkrim të sektorit të teknologjisë së informacionit, nëpërmjet të cilit shpjegohet dhe konfirmohet që programi i sistemit elektronik të administrimit të çështjeve të kësaj Gjykate nuk e mundëson realizimin e një procedure shorti lidhur me identitete funksionarësh që nuk janë gjyqtarë apo këshilltarë të kësaj Gjykate dhe për lloje çështjesh që nuk kanë natyrë gjyqësore.

Këshilli, pasi u njoh dhe diskutoi lidhur me pamundësinë teknike të realizimit të shortit në rrugë elektronike, me vendim të ndërmjetëm të mbledhjes së tij të datës 05.04.2019, vendosi të realizojë shortin në formën manuale, me praninë e anëtarëve të Këshillit, Avokates së Popullit dhe përfaqësuesve të subjekteve të ftuar sipas ligjit.

Në vijim, sipas rezultatit të shortit manual të realizuar nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, janë përcaktuar anëtarët e Këshillit relatorë për secilin nga vendet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë.

#### **7. Vendet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe për Inspektor i Lartë i Drejtësisë, numri i kandidatëve dhe i kandidimeve të shqyrtuara nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi gjatë vitit 2019**

Sipas nenit 125 të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese përbëhet nga 9 anëtarë, tre anëtarë emërohen nga Presidenti i Republikës, tre anëtarë zgjidhen nga Kuvendi dhe tre anëtarë zgjidhen nga Gjykata e Lartë. Sipas radhës së lindjes së kompetencës për plotësimin e vendeve vakante të përcaktuara në nenin 179 të Kushtetutës dhe në pikën 4 të nenit 86 të ligjit nr.8577/2000, si edhe shpalljes së vendit vakant në momentin e krijimit të tij, anëtarët e Gjykatës Kushtetuese, përzgjidhen nga secili prej këtyre tre organeve të emërtesës, ndërmjet kandidatëve të lejuar e të renditur në tri vendet e para të listës përfundimtare të miratuar nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, sipas ligjit.

Prandaj, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (I Përkohshëm) i zgjedhur për vitin 2019, në datën 05.04.2019, filloi zyrtarisht veprimtarinë e tij me procedurat e verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidaturave që kishin shprehur interesin për kandidim në vendet vakante për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese dhe për vendin vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, si më poshtë:

1. Vendi vakant, vakancë e plotë, në Gjykatën Kushtetuese, shpallur nga Gjykata e Lartë në datën 16.01.2017 brenda afateve të përcaktuara nga neni 9 i ligjit nr.8577/2000, për shkak të përfundimit në muajin Mars 2017 të afatit 9 vjeçar të mandatit të gjyqtarës Vitore Tusha. Për këtë vend vakant, në përfundim të afatit të shpalljes nga Gjykata e Lartë, kishin

#### ***Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (I Përkohshëm) 2019***

Adresa Postare : **GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.**

Adresa Elektronike : **info@ked.gov.al** Numra telefonikë : **+355 4 2257302**

shprehur interesin për kandidim 3 kandidatë. Pas tërheqjes nga kandidimi të dy prej kandidatëve, përkatësisht në muajin Janar dhe Mars të vitit 2019, pra përpara se të fillonin procedurat e verifikimit të kandidaturave nga Këshilli, për këtë vend vakant mbetej në listë vetëm një kandidat.

2. Vendi vakant, vakancë e plotë, në Gjykatën Kushtetuese, shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018, për shkak të përfundimit në muajin Prill të vitit 2016 të afatit 9 vjeçar të mandatit të gjyqtarit Sokol Berberi dhe njoftimit prej tij të dorëheqjes nga vazhdimi i detyrës në muajin Tetor 2016. Për këtë vend vakant, në përfundim të afatit të shpalljes nga Presidenti i Republikës, kishin shprehur interesin për kandidim 22 kandidatë.

3. Vendi vakant, vakancë e parakohshme, në Gjykatën Kushtetuese, shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018, për shkak të heqjes dorë nga gjyqtari Besnik Imeraj, në datën 31 Janar 2018, nga ushtrimi i mandatit përpara përfundimit të afatit 9 vjeçar të tij të përcaktuar në muajin Prill 2022. Për këtë vend vakant, në përfundim të afatit të shpalljes nga Presidenti i Republikës, kishin shprehur interesin për kandidim 15 kandidatë.

4. Vendi vakant, vakancë e plotë, në Gjykatën Kushtetuese, shpallur nga Kuvendi në datën 12.02.2018, për shkak të përfundimit në muajin Prill të vitit 2016 të afatit 9 vjeçar të mandatit të gjyqtarit Vladimir Kristo dhe njoftimit prej tij të dorëheqjes nga vazhdimi i detyrës në muajin Korrik 2017. Për këtë vend vakant, në përfundim të afatit të shpalljes nga Kuvendi, kishin shprehur interesin për kandidim 20 kandidatë.

5. Vendi vakant, vakancë e parakohshme, në Gjykatën Kushtetuese, shpallur nga Kuvendi në datën 28.08.2018, për shkak të shkarkimit nga detyra të gjyqtarit Fatos Lulo sipas vendimit nr.3 datë 17.07.2018 të Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe, për rrjedhojë, përfundimit përpara afatit të mandatit 9 vjeçar të përcaktuar në muajin Prill 2022. Për këtë vend vakant, në përfundim të afatit të shpalljes nga Kuvendi, kishin shprehur interesin për kandidim 6 kandidatë.

6. Vendi vakant, vakancë e parakohshme, në Gjykatën Kushtetuese, shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 09.11.2018, për shkak të shkarkimit nga detyra të gjyqtarës Altina Xhoxhaj sipas vendimit nr.9 datë 24.10.2018 të Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe, për rrjedhojë, përfundimit përpara afatit të mandatit 9 vjeçar të përcaktuar në muajin Maj 2019. Për këtë vend vakant, në përfundim të afatit të shpalljes nga Presidenti i Republikës, kishin shprehur interesin për kandidim 3 kandidatë.

7. Vendi vakant, vakancë e parakohshme, në Gjykatën Kushtetuese, shpallur nga Gjykata e Lartë në datën 21.11.2018, për shkak të shkarkimit nga detyra të gjyqtarit Fatmir Hoxha sipas vendimit nr.7 datë 25.09.2018 të Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe, për rrjedhojë, përfundimit përpara afatit të mandatit 9 vjeçar të përcaktuar në muajin Qershor 2020. Për këtë vend vakant, në përfundim të afatit të shpalljes nga Gjykata e Lartë, nuk kishte shprehur interes për kandidim asnjë kandidat.

8. Vendi vakant, vakancë e parakohshme, në Gjykatën Kushtetuese, shpallur nga Kuvendi në datën 24.12.2018, për shkak të shkarkimit nga detyra të gjyqtarit Bashkim Dedja sipas vendimit nr.12 datë 17.12.2018 të Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe, për rrjedhojë, përfundimit përpara afatit të mandatit 9 vjeçar të përcaktuar në muajin Maj 2019. Për këtë

***Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (I Përkohshëm) 2019***

Adresa Postare : **GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.**

Adresa Elektronike : **info@ked.gov.al** Numra telefonikë : **+355 4 2257302**

vend vakant, në përfundim të afatit të shpalljes nga Kuvendi, kishin shprehur interesin për kandidim 3 kandidatë.

9. Vendi vakant, vakancë e parakohshme, në Gjykatën Kushtetuese, shpallur nga Gjykata e Lartë në datën 21.02.2019, për shkak të shkarkimit nga detyra të gjyqtarit Gani Dizdari sipas vendimit nr.4 datë 12.02.2018 të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe, për rrjedhojë, përfundimit përpara afatit të mandatit 9 vjeçar të përcaktuar në muajin Prill 2022. Për këtë vend vakant, në përfundim të afatit të shpalljes nga Gjykata e Lartë, kishte shprehur interes për kandidim vetëm një kandidat.

10. Vendi vakant i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, vakancë e shpallur sipas dispozitave kalimtare kushtetuese dhe ligjore. Për këtë vend vakant kishin shprehur interesin për kandidim gjatë vitit 2017 katër kandidatë. Pas tërheqjes nga kandidimi të një kandidateje në Janar të vitit 2019, kishin mbetur 3 kandidatë. Në zbatim të Kushtetutës dhe ligjit, Këshilli rishpalli vendin vakant në datën 01.03.2019 dhe, në përfundim të afatit të shpalljes, shprehën interesin për kandidim 13 kandidatë. Përfundimisht me tërheqjen e menjëhershme të një kandidati, numri përfundimtar i kandidatëve për këtë vakancë ishte 12 kandidatë.

Gjithashtu, në përmbushje të detyrimeve që burojnë nga përcaktimet kushtetuese dhe ligjore mbi kompetencën e radhës së plotësisimit të vendeve vakante që krijohen në Gjykatën Kushtetuese, dy organet e emërtesës, Presidenti i Republikës dhe Kuvendi, secili në datën 04.03.2019, kanë shpallur thirrjen për shprehjen e interesit për kandidime në plotësimin e vendeve vakante, vakanca të plota, të lidhura përkatësisht edhe me përfundimin e afatit 9 vjeçar të përcaktuar në muajin Maj 2019, të mandateve përkatëse të gjyqtarëve Altina Xhoxhaj dhe Bashkim Dedja. Në përfundim të këtyre procedurave rezultoi si më poshtë:

11. Për vendin vakant, vakancë e plotë, në Gjykatën Kushtetuese, shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 04.03.2019, për shkak të përfundimit në muajin Maj 2019 të afatit 9 vjeçar të mandatit të gjyqtarës Altina Xhoxhaj, kishin shprehur interesin për kandidim 13 kandidatë.

12. Për vendin vakant, vakancë e plotë, në Gjykatën Kushtetuese, shpallur nga Kuvendi në datën 04.03.2019, për shkak të përfundimit në muajin Maj 2019 të afatit 9 vjeçar të mandatit të gjyqtarit Bashkim Dedja, kishin shprehur interesin për kandidim 9 kandidatë.

Në lidhje me të gjitha këto 12 vende vakante, në datën 05.04.2019, pra në momentin kur Këshilli i Emërimeve në Drejtësi zyrtarisht ka filluar procedurat e verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe të renditjes së kandidaturave për të gjitha këto vakanca, rezultoni të kandiduar **48 kandidatë për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese dhe 12 kandidatë për Inspektor i Lartë i Drejtësisë**, gjithsej në total **60 kandidatë**.

Ndërkohë për shkak të kandidimeve në më shumë se një vend vakant nga të njëjtë kandidatë, **numri i kandidimeve** për të cilat duhet të vendoste Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ishte **93 kandidime** për vakancat në Gjykatën Kushtetuese dhe **12 kandidime** për vakancën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, gjithsej në total **105 kandidime**.

Në kushtet kur për secilin vend vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallura nga Gjykata e Lartë përkatësisht në datat 16.01.2017 dhe 21.02.2019, kishte vetëm

***Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (I Përkohshëm) 2019***

Adresa Postare : **GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.**

Adresa Elektronike : **info@ked.gov.al** Numra telefonikë : **+355 4 2257302**

nga një kandidat, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, me vendimin nr. 6 datë 05.04.2019 “Për pezullimin e procedurës së verifikimit të kandidaturave dhe njoftimin e subjektit që e ka vënë në lëvizje, Gjykatën e Lartë, për të vlerësuar rishpalljen e thirrjes për paraqitjen e kandidaturave”, njoftoi Gjykatën e Lartë për gjendjen e krijuar dhe për të vlerësuar ushtrimin e kompetencës për rishpalljen e thirrjes për paraqitjen e kandidaturave të reja, me synimin për të pasur së paku tre kandidatë të interesuar për kandidim, në mënyrë që Këshilli të vijojë me procedurat e verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së tyre.

Për këto arsye, Gjykata e Lartë, në datën 19.04.2019, ka njoftuar rishpalljen e procedurës së shprehjes së interesit për kandidim në të tre vendet vakante në Gjykatën Kushtetuese të shpallura më parë nga Gjykata e Lartë, përkatësisht në datat 16.01.2017, 21.11.2018 dhe 21.02.2019.

Në përfundim të afatit 30 ditor të këtij njoftimi, sipas dokumentacionit të administruar në datat 22.05.2019 dhe 23.05.2019, rezulton se për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese të rishpallur, vakancë e plotë, të lidhur me përfundimin e rregullt të afatit 9 vjeçar të mandatit të gjyqtarës Vitore Tusha, kishin shprehur interesin për kandidim vetëm dy kandidatë. Për vendin vakant të rishpallur, vakancë e parakohshme, të lidhur me përfundimin përpara afatit 9 vjeçar të mandatit të gjyqtarit Gani Dizdari, kishin shprehur interesin për kandidim vetëm dy kandidatë. Ndërsa për vendin vakant të rishpallur, vakancë e parakohshme, të lidhur me përfundimin përpara afatit 9 vjeçar të mandatit të gjyqtarit Fatmir Hoxha, nuk kishte shprehur interes për kandidim asnjë kandidat.

Për rrjedhojë, me gjithë rishpalljen e vakancave nga Gjykata e Lartë në datën 19.04.2019, përsëri nuk ka qenë e mundur sigurimi i një liste prej së paku 3 kandidatësh për secilën vakancë, në mënyrë që Këshilli i Emërimeve në Drejtësi të vijojë ushtrimin e kompetencave të tij për verifikimin, vlerësimin, pikëzimin dhe renditjen e kandidaturave në secilin nga këto vende vakante.

Pas fillimit të procedurave të verifikimit të kandidatëve dhe caktimit të relatorëve për të gjitha vendet vakante, Këshilli realizoi komunikimet me të gjithë kandidatët për plotësimin e deklaratave dhe autorizimeve për qëllimet e verifikimit dhe kontrollit të kandidaturës, kërkoi informacione të hollësishme nga institucione publike dhe subjekte private lidhur me përmbushjen e kushteve ligjore të kandidimit për sa i përket integritetit pasuror, moral dhe kushteve të tjera specifike të kandidimit, analizoi informacionin e ardhur, komunikoi me kandidatët për gjetjet në procedurat e verifikimit dhe në përfundim të këtyre procedurave shqyrtoi në mbledhjet e Këshillit secilin rast kandidimi, duke vendosur, sipas rastit dhe ligjit të zbatueshëm, përfundimin e procedurës së verifikimit dhe renditjes për tërheqje nga kandidimi, ndalimin e kandidimit apo lejimin e kandidimit.

Për shkak të tërheqjeve nga kandidimet ose ndalimeve nga kandidimi, duke qenë se për vendin vakant, vakancë të parakohshme, për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Kuvendi në datën 28.08.2018 nuk kishte më kandidatë për tu vlerësuar, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vendosi të njoftojë organin e emërtesës, Kuvendin, për të rishpallur thirrjen për shprehjen e interesit për kandidime në plotësimin e atij vendi vakant.

Në përfundim të afatit 30 ditor të procedurës së shpalljes së thirrjes për aplikime të datës 21.08.2019, Kuvendi ka përcjellë pranë Këshillit listën prej 6 kandidatësh të kandiduar

***Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (I Përkohshëm) 2019***

Adresa Postare : **GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodë Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.**

Adresa Elektronike : **info@ked.gov.al** Numra telefonikë : **+355 4 2257302**

për këtë vend vakant. Menjëherë pas marrjes së dokumentacionit të kandidimeve nga organi i emërtesës, në datën 21.09.2019, Këshilli ka filluar kryerjen e procedurave të verifikimit të plotësimit të kushteve ligjore për këta kandidatë, të cilat janë në fazën e tyre përmbyllëse, atë të komunikimit me kandidatët të relacionit të përgatitur me gjetjet në procedurën e verifikimit, pra janë thuajse të gatshme për tu shqyrtuar nga mbledhja e Këshillit me përbërjen e re që do të ushtrojë funksionet gjatë vitit kalendarik 2020.

Për shkak të tërheqjeve nga kandidimet ose ndalimeve nga kandidimi, duke qenë se për vendin vakant, vakancë të parakohshme, për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018, mbetën në konkurrim vetëm dy kandidatë, ndërkohë që sipas Kushtetutës kërkohet një numër minimal prej 3 kandidatësh për të përzgjedhur nga organi i emërtesës, Këshilli vendosi të njoftojë Presidentin e Republikës, për të rishpallur thirrjen për plotësimin e atij vendi vakant.

Në përfundim të procedurës së shpalljes së thirrjes për aplikime të datës 27.09.2019, Presidenti i Republikës ka përcjellë pranë Këshillit listën prej 6 kandidatësh të kandiduar për këtë vend vakant. Menjëherë pas marrjes së dokumentacionit të kandidimeve nga organi i emërtesës, në datën 22.10.2019, Këshilli ka filluar kryerjen e procedurave të verifikimit të plotësimit të kushteve ligjore për këta kandidatë, të cilat janë në fazën e tyre përmbyllëse, për katër nga kandidatët në atë të komunikimit të relacionit të përgatitur me gjetjet në procedurën e verifikimit dhe për dy kandidatë në veprimet e pritshme të dhënies së përgjigjeve lidhur me gjetje në procedurën e verifikimit të tyre. Pra, edhe në lidhje me këtë vend vakant, janë thuajse të gatshme për tu shqyrtuar pjesa më e madhe e kandidaturave nga mbledhja e Këshillit me përbërjen e re që do të ushtrojë funksionet gjatë vitit kalendarik 2020.

Gjithashtu, për shkak të tërheqjeve nga kandidimet ose ndalimeve nga kandidimi, duke qenë se për vendin vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, edhe pas shpalljes së thirrjes për shprehje interesi për kandidime të bërë nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, mbetën vetëm 4 kandidatë të lejuar për kandidim, ndërkohë që sipas Kushtetutës kërkohet një listë prej 5 kandidatësh mes të cilëve bën zgjedhjen e tij Kuvendi, ky Këshill, në datën 09.09.2019, vendosi që të rishpallë thirrjen për shprehje interesi për kandidime të tjera në plotësim të atyre të katër kandidatëve tashmë të lejuar me vendime të Këshillit.

Në përfundim të procedurës së shpalljes së thirrjes për aplikime të datës 09.09.2019 për këtë vend vakant, rezultoi që paraqitën interesin për kandidim edhe katër kandidatë të rinj, të cilët, sipas përcaktimeve ligjore iu bashkuan katër kandidatëve të lejuar me vendime të Këshillit përpara kësaj shpalljeje të thirrjes për paraqitjen e kandidaturave të reja plotësuese.

Për rrjedhojë, numri i kandidatëve që i janë nënshtruar procedurave të verifikimit dhe të renditjes së kandidaturave për të gjitha vendet vakante gjatë vitit 2019 është **57 kandidatë për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese dhe 16 kandidatë për Inspektor i Lartë i Drejtësisë**, gjithsej në total **73 kandidatë**.

Ndërkohë për shkak të kandidimeve në më shumë se një vend vakant nga të njëjtë kandidatë, **numri i kandidimeve** për të cilat duhet të vendoste Këshilli tashmë, ishin **105 kandidime** për vakancat në Gjykatën Kushtetuese dhe **16 kandidime** për vakancën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, gjithsej në total **121 kandidime**.

#### ***Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (I Përkohshëm) 2019***

Adresa Postare : **GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.**

Adresa Elektronike : **info@ked.gov.al** Numra telefonikë : **+355 4 2257302**

8. *Ecuria dhe rezultatet e procedurave të verifikimit të kandidaturave në të gjitha vendet vakante për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese dhe për Inspektor i Lartë i Drejtësisë*

Pavarësisht nga situata në të cilën Gjykata Kushtetuese nuk ishte funksionale, po ashtu edhe Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në ushtrimin e veprimtarive dhe shqyrtimin e çështjeve në procedurën e verifikimit të kushteve ligjore të kandidimit, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (I Përkohshëm) i zgjedhur për vitin 2019, ka vepruar vetëm duke kontrolluar dhe gjykuar rigorozisht e në përputhje me përcaktimet e Kushtetutës dhe të ligjit, plotësimin e kushteve ligjore të kandidimit nga secili kandidat në të tre komponentët, ato të pasurisë, integritetit moral dhe kushteve të tjera ligjore të kandidimit.

Ndonëse ndjekin qëllime dhe qasje të ndryshme, sikurse parashikon Kushtetuta dhe ligjet apo edhe në frymën e tyre e për të cilën është kryer reforma në drejtësi, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (I Përkohshëm) i zgjedhur për vitin 2019, ka shfrytëzuar të gjitha hapësirat e mundshme ligjore dhe institucionale për të kryer shqyrtim dhe gjykim mbi integritetin e kandidaturave sipas standardeve që zbatohen në procesin e rivlerësimit kalimtar, edhe pse kjo veprimtari dhe me këto standarde e Këshillit ka qenë mjaft e vështirë për ty kryer sepse vetë mënyra e funksionimit, si edhe mjetet ligjore dhe burimet njerëzore etj. të këtij Këshilli janë dukshëm më të vogla se sa ato të organeve të rivlerësimit kalimtar.

Për rrjedhojë, për shkaqe të ndryshme, me fillimin ose gjatë kryerjes së procedurave rigorozë të verifikimit të plotësimin të kushteve ligjore të kandidimit nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, një numër i konsiderueshëm kandidatësh, **15 kandidatë** për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese dhe **5 kandidatë** për Inspektor i Lartë i Drejtësisë, janë tërhequr nga kandidimet.

Nga ana tjetër, për shkak se nga gjetjet në procedurat e verifikimit të kryera nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi u vërtetua që një pjesë e kandidatëve nuk plotësonin kushtet ligjore për të kandiduar, ky Këshill ka vendosur ndalimin e kandidimit edhe për një numër tjetër i konsiderueshëm kandidatësh, **20 kandidatë** për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese dhe **6 kandidatë** për Inspektor i Lartë i Drejtësisë,

Për kundërshtimin e vendimeve të Këshillit për ndalimin e kandidimit, që sipas ligjit lejohet vetëm për shkelje të rënda të procedurës së verifikimit, në Gjykatën Administrative të Apelit janë paraqitur paditë përkatëse nga **9 kandidatë të ndaluar** në kandidime për vendet vakante në Gjykatën Kushtetuese. Gjykata Administrative e Apelit ka rrëzuar të gjitha paditë, si të pambështetura në prova dhe në ligj, me përjashtim të dy padive të kandidatës së ndaluar Zhaklina Peto ku disponoi shfuqizimin e vendimeve përkatëse të Këshillit.

Në rastet e ndalimit të kandidimeve të kandidatës Zhaklina Peto në dy vende vakante në Gjykatën Kushtetuese, në vendimin e saj nr.201 datë 22.08.2019 për shfuqizimin e vendimeve nr.108 dhe 109 datë 02.08.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, Gjykata Administrative e Apelit konsideroi shkelje “të rëndë” procedurale mosnjofitimin formal të relacionit përfundimtar me gjetjet në procedurën e verifikimit të kandidaturës së saj përpara zhvillimit të mbledhjes së Këshillit ku u disponua ndalimi i kandidimit për mosplotësim të kriterit ligjor të integritetit pasuror. Relacioni ishte hartuar në përfundim të kryerjes së të

*Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (I Përkohshëm) 2019*

Adresa Postare : **GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.**

Adresa Elektronike : **info@ked.gov.al** Numra telefonikë : **+355 4 2257302**

gjitha procedurave dhe pas dhënies së shpjegimeve përkatëse të vetë kandidates për aq sa ajo e vlerësoi të nevojshme. Veprimi formal i njoftimit të relacionit përfundimtar nuk parashikohet nga ligji, por në vendimin normativ nr. 4/2019 të Këshillit, vetëm për qëllime të vënies në dijeni, njoftimit të kandidatit me përmbajtjen e këtij relacioni, por jo për të ushtruar kandidatja ndonjë të drejtë tjetër kundërshtimi ose shpjegimi. Gjithashtu, Gjykata vlerësoi në vendimin e saj se, krahas shqyrtimit të aktit të ekspertimit, Këshilli mund të kishte thirrur për sqarime në mbledhje ekspertin e caktuar që kishte dhënë mendim me shkrim për problematikat e integritetit pasuror të kandidates.

Nisur nga rasti i shqyrtimit gjyqësor të ndalimit të kandidimit të kandidates Zhaklina Peto dhe duke e shtrirë parashtrimin e disa qëndrimeve të tij edhe për çështje të tjera të lidhura me procesin dhe procedurat e verifikimit të kandidaturave, Presidenti i Republikës i është drejtuar Këshillit të Emërimeve në Drejtësi me shkresën nr. 2941/1 datë 31.08.2019.

Gjithsesi, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, duke zbatuar urdhërimet dhe orientimet e vendimit të gjykatës administrative të apelit, i rishqyrtoi të dy rastet e kandidimit të kandidates Zhaklina Peto dhe pas kryerjes së të gjitha procedurave përkatëse, duke ardhur në të njëjtat përfundime nisur vetëm nga ligji i zbatueshëm dhe gjetjet në procedurën e verifikimit, vendosi përsëri ndalimin e kandidimeve të kësaj kandidateje për mosplotësim të kriterit ligjor të integritetit pasuror.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (I Përkohshëm) i zgjedhur për vitin 2019, në veprimtarinë e tij, gjithashtu ka pasur edhe një numër të madh kandidatësh, 27 *kandidatë*, të cilët janë kandiduar njëkohësisht në më shumë se një vend vakant në Gjykatën Kushtetuese, gjë e cila është një e drejtë e tyre, përderisa Kushtetuta dhe ligji nuk përcaktojnë ndonjë kufizim të shprehur për këtë mundësi. Shumica e këtyre kandidatëve rezultojnë se janë tërhequr nga kandidimi ose është vendosur ndalimi i kandidimit nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi.

Në përfundim të procedurave të verifikimit të kandidaturave për të gjithë kandidatët dhe në të gjitha vendet vakante, Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (I Përkohshëm) të zgjedhur për vitin 2019, i rezultuan vetëm **6 kandidatë të lejuar** për kandidim në disa vende vakante të Gjykatës Kushtetuese, të cilët i plotësonin kushtet e kandidimit të përcaktuara nga Kushtetuta dhe ligji. Njëkohësisht, këta 6 kandidatë rezultojnë të kandiduar në katër vende vakante për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese në të cilat është arritur së paku numri minimal prej tre kandidatësh të cilët mund të vlerësohen, pikëzohen, renditen dhe në përfundim të dërgohen organeve të emërtesës, Presidentit të Republikës dhe Kuvendit, për të zgjedhur gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese, si më poshtë :

1. *Katër kandidatë të lejuar* për vendin vakant, vakancë e plotë, në Gjykatën Kushtetuese, shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018, për shkak të përfundimit në muajin Prill të vitit 2016 të afatit 9 vjeçar të mandatit të gjyqtarit Sokol Berberi dhe njoftimit prej tij të dorëheqjes nga vazhdimi i detyrës në muajin Tetor 2016.

2. *Tre kandidatë të lejuar* për vendin vakant, vakancë e plotë, në Gjykatën Kushtetuese, shpallur nga Kuvendi në datën 12.02.2018, për shkak të përfundimit në muajin Prill të vitit 2016 të afatit 9 vjeçar të mandatit të gjyqtarit Vladimir Kristo dhe njoftimit prej tij të dorëheqjes nga vazhdimi i detyrës në muajin Korrik 2017.

#### *Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (I Përkohshëm) 2019*

Adresa Postare : **GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.**

Adresa Elektronike : **info@ked.gov.al** Numra telefonikë : **+355 4 2257302**

3. *Katër kandidatë të lejuar* për vendin vakant, vakancë e plotë, në Gjykatën Kushtetuese, shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 04.03.2019, për shkak të përfundimit në muajin Maj 2019 të afatit 9 vjeçar të mandatit të gjyqtarës Altina Xhoxhaj.

4. *Tre kandidatë të lejuar* për vendin vakant, vakancë e plotë, në Gjykatën Kushtetuese, shpallur nga Kuvendi në datën 04.03.2019, për shkak të përfundimit në muajin Maj 2019 të afatit 9 vjeçar të mandatit të gjyqtarit Bashkim Dedja.

Ndërsa për vendin vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, pas dy shpalljeve të vakancës prej këtij Këshilli gjatë vitit 2019, në përfundim të procedurës së shpalljes së thirrjes për aplikime të datës 09.09.2019 për këtë vend vakant, rezultoi që paraqitën interesin për kandidim edhe 4 kandidatë të rinj, të cilët, iu bashkuan 4 kandidatëve të lejuar me vendime të Këshillit përpara shpalljes së kësaj thirrjeje për paraqitjen e kandidaturave të reja plotësuese.

Këshilli ka vijuar menjëherë me procedurat e verifikimit të plotësimit të kushteve ligjore për kandidim për këta kandidatë, në përfundim të së cilës ka vendosur lejimin e kandidimit për tre kandidatë. Gjithashtu, në kuadër të procedurave të verifikimit të realizuara pas datës 09.09.2019, përpara kalimit në fazën tjetër të procedurave të vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve të lejuar, janë tërhequr nga kandidimi dy kandidatë, si edhe është revokuar vendimi i lejimit të kandidimit dhe është ndaluar kandidimi për një kandidat.

Për rrjedhojë, Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (I Përkohshëm) të zgjedhur për vitin 2019, i rezultuan 5 kandidatë të lejuar për kandidim të cilët i plotësonin kushtet e kandidimit të përcaktuara nga Kushtetuta dhe ligji, gjë që plotëson parashikimin e nenit 147/d të Kushtetutës për listën prej 5 kandidatës të lejuar dhe renditur që i dërgohen Kuvendit për të zgjedhur Inspektorin e Lartë të Drejtësisë.

## **9. Ecuria dhe rezultatet e procedurave të vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve të lejuar në vendet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe për Inspektor i Lartë i Drejtësisë**

### **9.1 Vendet Vakante në Gjykatën Kushtetuese**

Në zbatim të Kushtetutës dhe të ligjit, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (I Përkohshëm) i zgjedhur për vitin 2019, pas përfundimit të procedurave përkatëse të verifikimit të kandidaturave, në datën 07.08.2019 filloi fazën tjetër të veprimtarisë së tij, atë të procedurave të vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve të lejuar për vendet vakante në Gjykatën Kushtetuese, si më poshtë:

1. Vendi vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e plotë, shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018, për shkak të përfundimit në muajin Prill të vitit 2016 të afatit 9 vjeçar të mandatit të gjyqtarit Sokol Berberi dhe njoftimit prej tij të dorëheqjes nga vazhdimi i detyrës në muajin Tetor 2016.

2. Vendi vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e plotë, shpallur nga Kuvendi në datën 12.02.2018, për shkak të përfundimit në muajin Prill të vitit 2016 të afatit 9

### ***Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (I Përkohshëm) 2019***

Adresa Postare : **GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodë Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.**

Adresa Elektronike : **info@ked.gov.al** Numra telefonikë : **+355 4 2257302**



vjeçar të mandatit të gjyqtarit Vladimir Kristo dhe njoftimit prej tij të dorëheqjes nga vazhdimi i detyrës në muajin Korrik 2017.

3. Vendi vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e plotë, shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 04.03.2019, për shkak të përfundimit në muajin Maj 2019 të afatit 9 vjeçar të mandatit të gjyqtarës Altina Xhoxhaj.

4. Vendi vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e plotë, shpallur nga Kuvendi në datën 04.03.2019, për shkak të përfundimit në muajin Maj 2019 të afatit 9 vjeçar të mandatit të gjyqtarit Bashkim Dedja.

Në këtë fazë të veprimtarisë së tij, e paraprirë nga veprimet e shumta përgatitore të kryera gjatës fazës së mëparshme të verifikimit të kandidatëve, në zbatim të dispozitave të Kushtetutës, të ligjit të posaçëm nr.8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, si edhe të ligjit nr. 115/2015 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (I Përkohshëm) i zgjedhur për vitin 2019 realizoi në datat 07.08.2019 dhe 09.08.2019 procedurat e relatimeve dhe intervistave me 6 kandidatët e lejuar.

Pas relatimit dhe intervistave me të gjithë kandidatët e lejuar Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka vijuar të qëndroj i mbledhur, sikurse urdhëron shprehimisht ligji, për shqyrtimin nga secili anëtar i Këshillit të dokumentacionit voluminoz të çdo kandidati të lejuar, për qëllimet e njohjes së plotë dhe të thelluar me të dhënat e jetës profesionale, me punimet shkencore dhe dokumentet e tjera profesionale të paraqitura për vlerësim nga kandidatët sipas profileve përkatëse profesionale, në funksion të përmbushjes së kompetencës së vlerësimit dhe pikëzimit të secilit kandidat.

Përfundimi i kësaj procedure brenda afatit ligjor 10 ditor u pamundësua kryesisht nga pranimi për shqyrtim i ankimit, tejkalimi i afatit të gjykimit dhe shpallja e vendimit nr. 201 datë 22.08.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit për shfuqizimin e vendimeve nr.108 dhe nr.109 datë 02.08.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi me të cilat ishte vendosur ndalimi i kandidimit të kandidatës Zhaklina Peto.

Pasi Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vendosi përsëri ndalimin e kandidimit të kandidatës Zhaklina Peto për kandidaturat në të dy vendet vakante në Gjykatën Kushtetuese ku kishte aplikuar, në vijim të procedurave të pandërprera të vlerësimit dhe pikëzimit të kandidatëve të lejuar dhe në përfundim të bisedimit kolegjal mbi vlerësimin individual të secilit prej gjashtë kandidatëve, për secilin kriter ligjor të meritave të tij/saj individuale, në datën 10.09.2019 Këshilli nxorri edhe rezultatin paraprak të pikëzimit të secilit prej tyre, të cilin e bëri menjëherë publik në faqen elektronike të Gjykatës së Lartë pjesa e caktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

Në zbatim të pikës 1 të nenit 125 dhe pikës 1 të nenit 149/d të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 7/b dhe pikës 4 të nenit 7/c të ligjit nr.8577/2000, si edhe të pikës 2 të nenit 239 dhe nenit 240 të ligjit nr.115/2016, në mbledhjen e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi të datës 21.09.2019 janë miratuar listat përfundimtare e renditjes së kandidatëve të lejuar dhe raporti i arsyetuar për renditjen e kandidatëve të lejuar për secilin nga katër vendet vakante në Gjykatën Kushtetuese, si më poshtë:

***Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (I Përkohshëm) 2019***

Adresa Postare : **GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.**

Adresa Elektronike : **info@ked.gov.al** Numra telefonikë : **+355 4 2257302**

1. Me vendimet nr.128 dhe nr.129 datë 21.09.2019 janë miratuar Lista Përfundimtare të Renditjes së Kandidatëve për Gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese dhe Raporti i Arsytuar për Renditjen e Kandidatëve të Lejuar në lidhje me vendin vakant, vakancë e plotë, të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018, me renditjen si më poshtë :

- 1) Arta Vorpsi 89.642 Pikë
- 2) Elsa Toska 85.428 Pikë
- 3) Besnik Muçi 81.928 Pikë
- 4) Regleta Panajoti 80.285 Pikë

2. Me vendimet nr. 130 dhe nr. 131 datë 21.09.2019 janë miratuar Lista Përfundimtare të Renditjes së Kandidatëve për Gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese dhe Raporti i Arsytuar për Renditjen e Kandidatëve të Lejuar në lidhje me vendin vakant, vakancë e plotë, të shpallur nga Kuvendi i Republikës në datën 12.02.2018, me renditjen si më poshtë :

- 1) Arta Vorpsi 89.642 Pikë
- 2) Elsa Toska 85.428 Pikë
- 3) Besnik Muçi 81.928 Pikë.

3. Me vendimet nr.132 dhe nr.133 datë 21.09.2019 janë miratuar Lista Përfundimtare të Renditjes së Kandidatëve për Gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese dhe Raporti i Arsytuar për Renditjen e Kandidatëve të Lejuar në lidhje me vendin vakant, vakancë e plotë, të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 04.03.2019, me renditjen si më poshtë :

- 1) Arta Vorpsi 89.642 Pikë
- 2) Fiona Papajorgji 88.785 Pikë
- 3) Elsa Toska 85.428 Pikë
- 4) Marsida Xhaferllari 82.000 Pikë

4. Me vendimet nr. 134 dhe nr. 135 datë 21.09.2019 janë miratuar Lista Përfundimtare të Renditjes së Kandidatëve për Gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese dhe Raporti i Arsytuar për Renditjen e Kandidatëve të Lejuar në lidhje me vendin vakant, vakancë e plotë, të shpallur nga Kuvendi i Republikës në datën 04.03.2019, me renditjen si më poshtë :

- 1) Arta Vorpsi 89.642 Pikë
- 2) Fiona Papajorgji 88.785 Pikë
- 3) Elsa Toska 85.428 Pikë

Për të ushtruar të drejtën e emërimit dhe të zgjedhjes së gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, secilit organ emërtese, Presidentit të Republikës dhe Kuvendit, për të dy vendet vakante përkatëse që i kishin në kompetencë për ti plotësuar, u janë dërguar Listat përfundimtare të renditjes së kandidatëve, Raportet e arsyetuar për renditjen, të shoqëruara me aktet përkatëse të verifikimit të të gjithë kandidatëve, aktet përkatëse të vlerësimit dhe pikëzimit të secilit kandidat të lejuar, si edhe akte të tjera të procedurës së vlerësimit të kandidaturave. Dërgimi i këtyre akteve është realizuar nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi dhe ato janë marrë në dorëzim në datën 08.10.2019 nga Institucioni i Presidentit të Republikës dhe në datën 14.10.2019 nga Kuvendi.

*Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (I Përkohshëm) 2019*

Adresa Postare : **GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.**

Adresa Elektronike : **info@ked.gov.al** Numra telefonikë : **+355 4 2257302**

Njëkohësisht, secilit organ emërtese, në Raportet e arsyetuar për renditjen e kandidatëve, i është bërë qartazi e ditur që, nëse e vlerësojnë ti kërkojnë, Këshilli do tu përcjellë menjëherë dhe sipas kërkesës përkatëse, edhe kopje të plotë a të pjesshme të dokumentacionit të administruar gjatë procedurave të verifikimit dhe të vlerësimit të kandidatëve të renditur.

*Brenda shtatë ditëve* nga dërgimi i listave përfundimtare të renditjes së kandidatëve, Raporteve të arsyetuar për renditjen dhe akteve përkatëse të sipërcituara, në datën 15.10.2019, Presidenti i Republikës, me Dekretin nr.11313 ka emëruar gjyqtar të Gjykatës Kushtetuese zotin Besnik Muçi, i renditur i treti në Listën Përfundimtare të Renditjes së Kandidatëve për vendin vakant, vakancë e plotë, të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018.

*Dy ditë përpara përfundimit të afatit 30 ditor* të ushtrimit ose jo të së drejtës së emërimit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese ndërmjet tre kandidatëve të renditur në tri vendet e para nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi sikurse parashikohet shprehimisht nga pika 1 e nenit 125 të Kushtetutës dhe pika 4 e nenit 7/b të ligjit nr.8577/2000, në datën 05.11.2019, Presidenti i Republikës ka dërguar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi një shkresë që mban nr.3535/1 prot datë 05.11.2019, por që është *paraqitur pranë Këshillit ditën e nesërme sikurse rezulton nga nr.713 prot datë 06.11.2019* të administrimit të tij nga zyra e pritjes së korrespondencës zyrtare dhe protokollit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Sipas kësaj shkrese, e cila i drejtohet njëkohësisht Kryetarit të Kuvendit, Kryetarit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi dhe Avokatit të Popullit, pas parashtrimit të një arsytimi të gjatë sipas këndvështrimit të Tij mbi mënyrën e interpretimit të Kushtetutës dhe ligjit për radhën e plotësimit të vendeve vakante, Presidenti i Republikës konkludon se, së pari, ka vendosur të “pezullojë” procesin e Tij të ushtrimit të së drejtës për emërimin e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese në vakancën e plotë të shpallur në datën 04.03.2019 derisa Kuvendi të ushtrojë të drejtën që i takon të zgjedhjes së një gjyqtari të Gjykatës Kushtetuese apo të përfundojë afati 30 ditor për këtë organ emërtese. Së dyti, i kërkon Këshillit të Emërimeve në Drejtësi plotësimin e praktikës dokumentare me kopje të dokumentacionit të administruar nga KED në dosjen e kandidimit të secilit prej katër kandidatëve të lejuar për vendin vakant, vakancë e plotë, shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 04.03.2019. Së treti i kërkon bashkëpunim Kuvendit që të zgjedhë në kohë të shkurtër një anëtar të Gjykatës Kushtetuese.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi u thirr në mbledhjen e tij në datën 07.11.2019 për të shqyrtuar qëndrimet dhe arsytimet e Presidentit të Republikës dhe kërkesën për dërgimin e kopjeve të plotë të dosjeve të kandidimit për katër kandidatët e lejuar në vendin vakant të shpallur nga Presidenti në datën 04.03.2019.

Kjo mbledhja e Këshillit konkludoi se në kushtet kur i ka përfunduar procedurat e verifikimit, vlerësimit dhe renditjes së kandidatëve për katër vende vakante, dy për secilin organ emërtese, përkatësisht për Presidentin e Republikës dhe Kuvendin, duke dërguar pranë tyre edhe Listat Përfundimtare të Renditjes së Kandidatëve, vlerëson ti përcjellë sipas kërkesës së paraqitur Institucionit të Presidentit të Republikës kopje të dokumentacionit të administruar dhe të shqyrtuar që përmban dosja e kandidimit të secilës prej 4 kandidateve të listuar nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, për plotësimin e vendit vakant në Gjykatën

***Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (I Përkohshëm) 2019***

Adresa Postare : **GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodri Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.**

Adresa Elektronike : **info@ked.gov.al** Numra telefonike : **+355 4 2257302**

Kushtetuese, të shpallur nga Presidenti i Republikës me Dekretin nr. 11133 datë 04.03.2019, për disponibilitetin e dërgimit të të cilave Këshilli e ka vënë në dijeni prej kohësh këtë organ emërtese me *Raportin e Arsyetuar* për Renditjen e Kandidatëve të Lejuar për plotësimin e këtij vendi vakant, përcjellë pranë Institucionit të Presidentit me shkresën nr. 553 prot datë 08.10.2019. Kopja e dokumentacionit të kërkuar ishte përcjellë tashmë nga Kryetari i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi dhe ishte marrë në dorëzim nga pranë Institucionit të Presidentit të Republikës po në datën 07.11.2019.

Kryetari i Kuvendit, me shkresën nr.3973 datë 08.11.2019 drejtuar Kryetarit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, të administruar pranë Këshillit në po të njëjtën ditë, ka kërkuar që brenda asaj dite të dërgohet informacion mbi ecurinë e procesit të emërimit anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese nga Presidenti i Republikës në kushtet kur Komisioni i Ligjeve ka përfunduar procedurat dhe miratuar raportet për zgjedhje në seancë plenare të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese për të dy vendet vakante në kompetencë të Kuvendit, nisur edhe nga konstatimi se ka kandidatë që ndodhen si në listat përfundimtare që Këshilli i Emërimeve në Drejtësi i ka dërguar Kuvendit ashtu edhe në ato të dërguara Presidentit të Republikës.

Kryetari i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, me shkresën nr.716/1 datë 08.11.2019 i ka dërguar Kryetarit të Kuvendit informacionin e kërkuar mbi ecurinë dhe rezultatet përfundimtare të procedurave të verifikimit, vlerësimit dhe renditjes së kandidaturave për katër vendet vakante, vakanca të plota, dy për secilin organ emërtese, Presidenti i Republikës dhe Kryetari i Kuvendit, për përcjelljen e vendimeve për miratimin e listave përfundimtare, Raporteve të arsyetuar për renditjen, vendimeve dhe akteve të tjera të miratuara nga Këshilli për kandidatët në këto vende vakante, si edhe të dhënat e tjera mbi ecurinë e plotësimit të vakancave që rezultonin nga praktikat dhe korrespondencat zyrtare, përfshirë ato të bëra publike në faqet zyrtare të secilit institucion, në kuptim të Kushtetutës e të ligjit dhe konstatimeve faktike lidhur me këto ecuri në datën 08.11.2019.

## 9.2 Vendi Vakant i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë

Në zbatim të Kushtetutës dhe të ligjit, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (I Përkohshëm) i zgjedhur për vitin 2019, pas përfundimit të procedurave përkatëse të verifikimit të kandidaturave, në datën 11.12.2019, filloi fazën tjetër të veprimtarisë së tij, atë të procedurave të vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve të lejuar për vendin vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Në këtë fazë të veprimtarisë së tij, njësoj si në rastin e vendeve vakante për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (I Përkohshëm) i zgjedhur për vitin 2019, realizoi procedurat e relatimeve dhe intervistave me pesë kandidatët e lejuar, në datën 11.12.2019.

Pas relatimit dhe intervistave me të gjithë kandidatët e lejuar, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka vijuar të qëndroj i mbledhur, sikurse urdhëron shprehimisht ligji, për shqyrtimin nga secili anëtar i Këshillit të dokumentacionit voluminoz të çdo kandidati të lejuar, për qëllimet e njohjes së plotë dhe të thelluar me të dhënat e jetës profesionale, me punimet shkencore dhe dokumentet e tjera profesionale të paraqitura për vlerësim nga kandidatët sipas

### *Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (I Përkohshëm) 2019*

Adresa Postare : *GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.*

Adresa Elektronike : [info@ked.gov.al](mailto:info@ked.gov.al) Numra telefonikë : +355 4 2257302

profileve përkatëse profesionale, në funksion të përmbushjes së kompetencës së vlerësimit dhe pikëzimit të secilit kandidat.

Në vijim të procedurave të pandërprera të vlerësimit dhe pikëzimit të kandidatëve të lejuar dhe në përfundim të bisedimit kolegjal mbi vlerësimin individual të secilit nga pesë kandidatët, për secilin kriter ligjor të meritave të tij/saj individuale, në datën 16.12.2019, Këshilli nxorri edhe rezultatin paraprak të pikëzimit të secilit prej tyre, të cilin e bëri menjëherë publik në faqen elektronike të Gjykatës së Lartë pjesa e caktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

Në datën 23.12.2019, në mbledhjen e Këshillit, me vendimet nr.153 dhe nr.154 datë 23.12.2019 janë miratuar Lista Përfundimtare të Renditjes së Kandidatëve të Lejuar për Inspektor i Lartë i Drejtësisë dhe Raporti i Arsyetuar për Renditjen e Kandidatëve të Lejuar për Inspektor i Lartë i Drejtësisë, shpallur nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, me renditjen si më poshtë :

1. Artur Metani 89.6 Pikë
2. Sokol Stojani 89 Pikë
3. Joana Asimi Sorraj 82.2 Pikë
4. Eris Hysi 78.3 Pikë
5. Lindita Troja 63.4 Pikë

Lista Përfundimtare e Renditjes së Kandidatëve të Lejuar, Raporti i Arsyetuar për Renditjen e Kandidatëve të Lejuar dhe aktet përkatëse të verifikimit të të gjithë kandidatëve, aktet përkatëse të vlerësimit dhe pikëzimit të secilit kandidat të lejuar, si edhe akte të tjera të procedurës së vlerësimit të kandidaturave i janë dërguar brenda afatit ligjor tre ditor, në datën 26.12.2019, organit të emërtesës, Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, për të ushtruar të drejtën e zgjedhjes së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë brenda afatit 30 ditor nga e nesërmja e ditës së dorëzimit të këtyre akteve, ndërmjet pesë kandidatëve të renditur nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi.

#### **10. Disa të dhëna për mbledhjet, aktet e nxjerra dhe ngarkesën e punës së përballuar nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (I Përkohshëm) i zgjedhur për vitin 2019**

Për realizimin e të gjitha këtyre veprimtarive, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (I Përkohshëm) i zgjedhur për vitin 2019, ka realizuar **39 mbledhje të Këshillit** me një kohëzgjatje totale 102 orë dhe 3 minuta ose mesatarisht 2 orë dhe 37 minuta për çdo mbledhje. Në mbledhjet e Këshillit, me përjashtime të rralla, kanë qenë të pranishëm të gjithë anëtarët e Këshillit. Po kështu, në mbledhje të Këshillit kanë marrë pjesë edhe anëtarët zëvendësues kur është kërkuar prania e tyre në mbledhje, veçanërisht deri në muajin prill kur përfundoi procesi legjislativ i përgatitjes, diskutimit dhe miratimit të akteve nënligjore nga ana e Këshillit.

Gjithashtu, në të gjitha mbledhjet e Këshillit, me statusin e tyre të vëzhguesit, kanë marrë pjesë Avokati i Popullit ose një përfaqësues i autorizuar prej tij, si edhe përfaqësuesi i Presidentit të Republikës, të cilët kanë marrë pjesë aktivisht, duke shprehur mendime, qëndrime dhe sugjerime për çështjet e rendit të ditës. Subjektet e tjera të ftuara sipas ligjit, po

#### ***Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (I Përkohshëm) 2019***

Adresa Postare : **GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.**

Adresa Elektronike : **info@ked.gov.al** Numra telefonikë : **+355 4 2257302**

me statusin e vëzhguesit, përfaqësuesi i Kryetarit të Kuvendit ka qenë i pranishëm dhe ka shprehur mendimet, qëndrime dhe sugjerime të tij në një pjesë të mbledhjeve të Këshillit, ndërsa dy deputetët të Komisionit të Ligjeve, përfaqësues të shumicës dhe opozitës parlamentare, kanë qenë të pranishëm në mbledhjet e Këshillit dhe kanë marrë pjesë aktivisht, duke shprehur mendimet, qëndrimeve dhe sugjerimet e tyre vetëm në muajt e parë të veprimtarisë së Këshillit.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (I Përkohshëm) i zgjedhur për vitin 2019, në procesin e miratimit të akteve nënligjore, si edhe gjatë kryerjes së procedurave të verifikimit të kandidaturave dhe atyre të vlerësimit, pikëzimit dhe të renditjes së kandidatëve të lejuar për të gjitha vendet vakante në proces ka shqyrtuar projektetaktet përkatëse dhe ka nxjerrë **154 vendime**.

Për të siguruar mundësinë e njohjes sa më të thellë dhe aktuale të kandidatëve, organeve të emërtesës, subjekteve të interesuara dhe publikut në tërësi me veprimtarinë dhe vendimmarrjen e Këshillit dhe për të kontribuar më tej në transparencën e veprimtarisë së tij, të gjitha vendimet e Këshillit për rastet e shqyrtuara në procedurat e verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve janë të publikuara në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, pjesa e posaçme e dedikuar Këshillit të Emërimeve në Drejtësi. Këto vendime janë të arsyetuara në mënyrë të hollësishme në lidhje me çdo veprim e procedurë të ndjekur nga Këshilli, me vlerësim të fakteve dhe ligjit të zbatueshëm për çdo gjetje apo të dhëne që lidhej me kandidaturën, si edhe janë shoqëruar me publikimin e akteve të tjera të lidhura me procesin e kandidimit, vlerësimit dhe pikëzimit të kandidatëve, ndonëse një pjesë e tyre nuk janë të parashikuara ose të detyrueshme për tu bërë publike nga ana e Këshillit.

Kryetari dhe zëvendëskryetari i Këshillit, në zbatimin të kompetencave për vendimmarrje në rastet e ngritura për heqje dorë nga anëtarët e Këshillit ose të kërkesave të kandidatëve për përjashtim të anëtarëve nga procedurat e verifikimit dhe vlerësimit të kandidaturave për papajtueshmëri ose konflikti i interesit, kanë nxjerrë **10 vendime**.

Kryetari i Këshillit, krahas numrit të konsiderueshëm të komunikimeve zyrtare shkresore me institucione dhe subjekte të tjera në kuadër të zhvillimit të procedurave të verifikimit, vlerësimit dhe renditjes së kandidaturave, si edhe për të siguruar mbështetjen më të mirë të mundshme për veprimtarinë e Këshillit, në zbatimin të kompetencave të caktuara me ligj, ka nxjerrë edhe **2 urdhra** që lidhen me miratimin e rregullave të hollësishme të çështjeve të plotësimit të kushteve për pranimin, ruajtjen dhe administrimin e informacioneve të klasifikuara, që dërgohen në kuadër të procedurave të verifikimit të kandidatëve nga organet ligjzbatuese sipas ligjit.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (I Përkohshëm) i zgjedhur për vitin 2019, gjatë veprimtarisë së tij dhe në funksion të përmbushjes së procedurave për kontrollin, verifikimin dhe vlerësimin e kandidaturave, i është drejtuar institucioneve të tjera publike dhe subjekteve private me **493 shkresa**.

Në përgjigje të komunikimeve të sipërcituara të Këshillit, nga ana e institucioneve publike dhe subjekteve private, i janë përcjellë Këshillit, **1574 shkresa** me komunikime, shpjegime, qëndrime dhe informacione të tjera.

#### ***Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (I Përkohshëm) 2019***

Adresa Postare : **GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodë Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.**

Adresa Elektronike : **info@ked.gov.al** Numra telefonikë : **+355 4 2257302**

Në këtë volum komunikimesh dhe shkëmbimi informacionesh, nuk janë përfshirë edhe komunikimet, kërkimi, dërgimi, pranimi dhe përpunimi i një numri të konsiderueshëm, të pandërprerë dhe të përafërt në aspektin sasior me atë shkresor të sipërcituar, të kërkesave dhe përgjigjeve ndërmjet Këshillit dhe të gjithë kandidatëve në të gjitha vendet vakante, si edhe me institucione publike dhe subjekte private.

Është vendi për të evidentuar që përtej këtij numri, dokumentet shkresore të sjella për shqyrtim dhe përpunim informacioni pranë Këshillit, në pjesën më të madhe të tyre, secila nga ato shkresa, përmbajnë një numër të konsiderueshëm të dhënash apo sasi voluminoze informacionesh, gjë që ka përbërë dhe vijon të përbëjë një sfidë të pazakontë pune që ka kërkuar angazhim të jashtëzakonshëm në detyrë të anëtarëve të Këshillit, sikurse edhe të këshilltarëve dhe personelit tjetër administrativ të Gjykatës së Lartë, të cilët, krahas ngarkesës së punës së tyre të përditshme po aq të jashtëzakonshme pranë kësaj Gjykate, kanë qenë të ngarkuar për të punuar me kohë të pjesshme edhe pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

### **11. Disa problematika për garantimin e mbështetjes administrative të veprimtarisë së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (I Përkohshëm) i zgjedhur për vitin 2019**

Në këtë raport përfundimtar është paraqitur veprimtaria e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (I Përkohshëm) të zgjedhur për vitin 2019. Ky Këshill, me këtë përbërje, ishte i pari i cili, jo vetëm mori përsipër detyrën, por edhe realizoi, në të gjithë shtrirjen dhe në cikël të plotë, të gjitha llojet e kompetencave, përgjegjësi dhe veprimtarive që Kushtetuta dhe ligjet e nxjerra në pajtim me të, të miratuara gjatë vitit 2016, kishin përcaktuar për këtë organ të ri kushtetues.

Njëkohësisht, ky Këshill, me këtë përbërje, jo vetëm që do të duhej të jetësonte për herë të parë parashikimet kushtetuese dhe ligjore për misionin, përgjegjësitë dhe kompetencat e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, por edhe kishte barrën e jashtëzakonshme, të paparashikuar dhe përtej motiveve të Kushtetutbërësit, i cili e ka ndërtuar si organ kolegjal me kohë të pjesshme, pa buxhet, infrastrukturë dhe personel të vetin, që ta realizonte këtë detyrë dhe sfidë në kushtet kur ishin krijuar dhe ishin administruar pranë Këshillit dokumentacioni i kandidimeve për të gjitha vendet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe atë të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ndërkohë që të dy këto institucione kushtetuese ishin jofunksionale.

Nga ana tjetër, gjithashtu përtej parashikimeve të Kushtetutbërësit, edhe Gjykata e Lartë, e cila sipas Kushtetutës dhe ligjit, duhet të sigurojë gjithë mbështetjen e nevojshme për Këshillin me buxhet dhe personel administrativ, që në fillim të vitit 2019 funksiononte vetëm me tre gjyqtarë dhe me numër ndjeshëm të reduktuar të këshilltarëve ligjore (vetëm 9 nga rreth 30 këshilltarë që ka pasur përpara mesit të vitit 2018), si edhe të personelit të sekretarisë gjyqësore.

Kjo situatë tejet e vështirë nuk ka qenë e mundur të përmirësohet gjatë vijimit të vitit 2019, në të cilin, pavarësisht statusit jofunksional për mungesë gjyqtarësh, duke pasur parasysh rritjen e ndjeshme e të pandërprerë të numrit të dosjeve të ardhura për shqyrtim, Gjykata e Lartë ka qenë e detyruar sipas ligjit dhe ka qenë e angazhuar vetë intensivisht për të

#### ***Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (I Përkohshëm) 2019***

Adresa Postare : **GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.**

Adresa Elektronike : **info@ked.gov.al** Numra telefonikë : **+355 4 2257302**

vijuar përpunimin e dosjeve gjyqësore dhe përgatitjen e tyre për relativisht të shpejtë tashmë me mijëra dosje të gatshme në momentin kur kjo Gjykatë të kthehet funksionale.

Pavarësisht nga këto vështirësi të jashtëzakonshme, për aq sa ka qenë e mundshme në raport të edhe me detyrimet e administrimit dhe përpunimit të dosjeve të dosjeve dhe detyrimeve të tjera të paparashikuara administrative ndaj KLGJ, KPK, KPA etj., Gjykatat e Lartë ka avënë në dispozicion personeli administrativ mbështetës me kohë të pjesshme në shërbim të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Në të tilla rrethana, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (I Përkohshëm) i zgjedhur për vitin 2019, është ndëshur me vështirësi të shumta për të mundur realizimin normal të veprimtarisë së tij në të gjitha komponentët e procesit vendimarrës të veprimtarive procedurale dhe të veprimeve mbështetëse për realizimin e tyre sipas kërkesave të ligjit.

Në këtë drejtim, pavarësisht vullnetit të mirë dhe bashkëpunimit nisur nga mundësitë tejet të kufizuara për të caktuar dhe angazhuar personel administrativ pranë Këshillit, Gjykatat e Lartë ka caktuar, gjithsesi me kohë të pjesshme, në pjesën më të madhe të vitit, vetëm tre punonjëse administrative me detyra të njëkohshme të sekretarisë së mbledhjeve, sekretarisë së procedurave dhe të veprimtarisë të arkivit, protokollit etj. pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi. Kjo ka sjellë si rezultat edhe pamundësinë objektive që ky këshill të përmbushë në mënyrë dhe kohë e duhur diçka nga detyrimet e tij.

Në këto kushte, përgjatë zhvillimit intensiv të procedurave të përgatitjes dhe miratimit të akteve nënligjore dhe veçanërisht të procedurave të verifikimit, vlerësimit dhe renditjes së kandidaturave, ishte dhe është absolutisht prioritarë që kapacitetet administrative në dispozicion të Këshillit të angazhoheshin për këto qëllime, duke konsideruar edhe afatet që diktohen nga ligji dhe nevojën për të realizuar në kohën më të shpejtë dhe të arsyeshme këto procedura, për të mundur organeve të emërtesës të ushtrijnë kompetencat që mundësisht të bënin funksionale Gjykatën Kushtetuese dhe Inspektorin e Lartë të Drejtësisë.

Prandaj, ndonëse ka realizuar me cilësi një volum pune të jashtëzakonshëm dhe të paparashikuar nga ligji, Këshilli të Emërimeve në Drejtësi (I Përkohshëm) i zgjedhur për vitin 2019, nuk ka mundur të realizojë njërin nga detyrimet e përcaktuara me ligj, përmbylljen në kohë të proceseve të dëgjimit, transkriptimit dhe përgatitjes së procesverbaleve të përmbledhura të mbledhjeve të Këshillit. Ky proces i rëndësishëm për procedurat dhe veprimtarinë e Këshillit, si edhe për transparencën dhe njohjen e publikut me punën dhe veprimtarinë e Këshillit, duhet të realizohet gjithmonë në periudhat ndërmjet dy mbledhjeve të Këshillit.

Për motivet që tregohen në mënyrë të përmbledhur më sipër kjo detyrë nuk ka qenë e mundur të realizohet. Ky detyrim mund të realizohet, por në kushtet e burimeve njërezore etj. të kufizuara, do të realizohet duke neglizhuar apo mosrealizuar nga ana tjetër, në cilësinë dhe kohën e duhur veprimet intensive dhe në zinxhir procedurale të verifikimit, vlerësimit dhe renditjes së kandidaturave të vendeve vakante në proces. Vetëm me dehtësimin e pjesshëm dhe të përkohshëm të ngarkësive të punës në tremujorin e fundit të vitit, është mundur dyfishimi i punonjësve administrativë të Gjykatës së Lartë në dispozicion të Këshillit dhe përgatitja e të gjitha procesverbaleve të përmbledhura të mbledhjeve të Këshillit, të cilat sipas



ligjit, janë publikuar tashmë në faqen elektronike të Gjykatës së Lartë, pjesa për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

Së fundi, nisur nga kjo përvojë e vitit 2019, për funksionimin sa më normal dhe efektiv të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi për vitin 2020, krahas disa përmirësimeve në pajisje teknike, përbën domosdoshmëri që të angazhohen pranë këtij Këshilli së paku edhe dy apo tre specialiste të tjera të sekretarisë gjyqësore, në mënyrë që së bashku me personelin aktual të sekretarisë që tashmë e ka fituar përvojën e duhur për të kryer detyrat specifike në Këshill, do të ndikojnë pozitivisht në përballimin e të gjitha ngarkesave të punës administrative mbështetëse për procedurat komplekse të verifikimit dhe vlerësimit të kandidaturave, si edhe atyre të përgatitjes dhe realizimit të mbledhjeve të Këshillit.

## **12. Disa problematika që rezultojnë me legjislacionin në fuqi gjatë veprimtarisë së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (I Përkohshëm) i zgjedhur për vitin 2019**

Nisur nga të dhënat e përfituara nga përvoja dhe problematikat që rezultuan gjatë përgatitjes dhe miratimit të akteve nënligjore, si edhe gjatë ushtrimit të kompetencave dhe përgjegjësive të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (I përkohshëm) për vitin 2019, nga arritjet, problematikat dhe mosarritjet në aspekte të caktuara, sikurse u përmendën në Raport, vlerësohet se është vendi që, për një funksionim sa më normal dhe sa më efektiv të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi për kryerjen e procedurave të verifikimit, vlerësimit dhe renditjes së kandidaturave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë të diskutojë dhe miratojë një paketë normash të reja me shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.115/2016, në Pjesën V të tij, me konkretisht në:

- Kreun II “Përbërja e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi”, për të garantuar funksionalitetin e Këshillit e në veçanti lidhur me mundësimin e numrit të përcaktuar në Kushtetutë të anëtarëve në përbërje të Këshillit gjatë gjithë vitit kalendarik të ushtrimit të detyrës së këtij institucioni;

- Kreun III “Organizimi dhe funksionimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi” lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me kompetencat e kryetarit, rregullat e funksionimit të Këshillit dhe të atyre mbi mbështetjen administrative të Gjykatës së Lartë për Këshillin, rregullave mbi natyrën e mbyllur ose jo të mbledhjeve, për procedurat e zbatueshme në to dhe në vendimmarrjen e Këshillit, rregullave mbi natyrën dhe përmbajtjen e procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit, rregullave mbi statusin, pozicionin dhe sjelljen e Avokatit të Popullit dhe subjekteve të ftuar në lidhje me mbledhjet dhe veprimtaritë e Këshillit etj.;

- Kreun IV dhe V për të shtuar dhe qartësuar rregulla më të hollësishme dhe konkrete mbi procedurat dhe kompetencat e Këshillit për të kryer verifikimet dhe vlerësimet e kandidatëve, sa më të përafërta me ato të organeve për rivlerësimin kalimtar, ndonëse këto organe janë krijuar dhe ndjekin qëllime të tjera nga ato të Këshillit;

- Kreun VI “Përgjegjësia disiplinore e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi”, në nenin 242 shkronjat “c” dhe “ç”, veçanërisht nëse do të vlerësohet se është vendi për të rishikuar dispozita të Kreut III mbi natyrën dhe llojet e mbledhjeve të Këshillit dhe procedurat që ndiqen për verifikimin dhe vlerësimin e kandidaturave.

### ***Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (I Përkohshëm) 2019***

Adresa Postare : **GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.**

Adresa Elektronike : **info@ked.gov.al** Numra telefonikë : **+355 4 2257302**

Gjithashtu, në aspektin e procesit legjislativ, edhe në ligjin nr.8577/2000 mund të diskutohen dhe miratohen nga Kuvendi disa shtesa dhe ndryshime, veçanërisht në nenet 7/b, 7/c dhe 7/ç, për të qartësuar procedurat që ndiqen nga organet e emërtesës dhe nga Këshilli i Emërimeve në drejtësi për plotësimin e vakancave përkatëse në Gjykatën Kushtetuese, ekzistencën, rastet, kuptimin dhe mënyrën e zbatimit të rregullit të paraqitjes së dy listave me gjyqtarë dhe jogjyqtarë kur ka më shumë se një vend vakant në shqyrtim nga i njëjti organ emërtese, lidhur me afatet, hapat proceduralë, komunikimin, kompetencat dhe përgjegjësitë e organeve të emërtesës në proceset e plotësimit të vendeve vakante, si edhe për të harmonizuar në tërësi gjuhën dhe rregullat materiale e procedurale të këtij ligji të posaçëm me ato të ligjit nr.115/2016 që përmban rregullime të natyrës më të përgjithshme.

**KRYETARI**  
**ARDIAN DVORANI**  
